

Leksiku terminologjik i mekanikës si bazë për ndriçimin e shumë problemeve teorike të terminologjisë

Prof. Ass. Sadete PLLANA,

FE Prishtinë

E-mail: sadetepllana@outlook.com

Dr. Gani PLLANA,

FIM Prishtinë

E-mail: ganipllana44@hotmail.com

Përmbledhje

Nga shqyrtimi që i kemi bërë rrugëve të ndërtimit të termave bazë të mekanikës, të cilët shërbejnë vetë si elemente përbërëse të termave togfjalësh, del se një rrugë me interes të veçantë studimi është rruga semantike, meqë termat e krijuar shfaqen si lidhje të gjuhës së përgjithshme me leksikun terminologjik të fushës përkatëse.

Për studimin e leksikut në fjalë si leksik bazë, por edhe i përbashkët për nënfushat e tjera të mekanikës, vlerë të veçantë merr veçimi dhe identifikimi i këtij leksiku me teknologjinë mekanike, automobilin etj.

Një vend më vete zënë termat bazë, kur vështrohen si mjete për ndërtimet togfjalëshe, të cilat në terminologjinë e mekanikës zënë 70-80% të të gjitha njësive emërtuese terminologjike.

Marrë në tërësinë e saj gjithë kjo shtresë leksikore speciale e mekanikës shërben si bazë edhe për mjaft terminologji të tjera teknike.

Fjalë kyç: *leksiku terminologjik, mekanikë, probleme teorike*

Hyrje

Veçimi i terminologjisë si fushë e mëvetësuar studimi¹ e gjuhësisë (e leksikologjisë) dhe si leksik special (i organizuar në sistem i një fushe të veçantë të dijes)² në gjuhët e vendeve me teknologji të zhvilluar është pranuar qysh në mesin e shekullit të 20-të. Si vepra të para që hodhën bazat e terminologjisë si fushë studimi mund të përmendim "Standardizimi në

¹ H. Felber, "Terminology manual", UNESCO and Infoterm, Paris, 1984.

² Shih 1.

teknikë” (E. Vyster³, Austri) dhe ”Bazat e terminologjisë” (Lote⁴, Rusi). I përmendim këto dy vepra për të nxjerrë në pah se objekt i studimit të tyre janë bërë në pjesën më të madhe dy fusha të rëndësishme të dijës, të identifikuar në atë kohë (në vitet -30 të shek. XX), siç janë edhe sot, mekanika dhe elektriciteti.

Parimet e përgjithshme të terminologjisë dhe metodat e përpunimit të saj

Pikërisht leksiku terminologjik i mekanikës, ka shërbyer si bazë për të ndriçuar shumë probleme teorike të terminologjisë, sidomos lidhur me parimet bazë të saj, të cilat u shtrinë edhe në terminologjitë e tjera. Madje Vysteri, i cili me vonë u cilësua si babai i terminologjisë, i zbatoi praktikisht parimet e përgjithshme të terminologjisë dhe metodat e përpunimit të saj në veprën terminografike "Veglat prerëse" ("Machine tool"⁵). Edhe në ditët e sotme kjo vepër mbetet si model i hartimit të një fjalori të mirëfilltë terminologjik (i tipit sistemor me përkufizime). Ndonëse ky fjalor u hartua me metoda klasike (tradicionale), ai shërben si model edhe në ditët e sotme për hartimin e fjalorëve me mjete elektronike (kompjuterike). Nga sa thamë më sipër del se terminologjia e fushës së mekanikës mbetet si truall i gjerë, në të cilin mund të mbështetemi në leksikon e nënfushave të shumta të saj për t'u thelluar më tej në studimin e veçantë të tyre. Mund të theksohet se për disa nënfusha, si nënfusha e automobilin, e makinave metalprerëse, e detaleve të makinave, janë hartuar një varg fjalorësh dy e më shumë gjuhësh me një numër të madh termash, sidomos në vendet me teknologji të zhvilluara, si në Angli, në Gjermani, në Itali, në Rusi etj.⁶

³ E. Wüster, "*Internationale Sprachnormung in der Technik*", UDI, Berlin, 1931.

⁴ D. Lotte, "*Osnovi postroyenija naučno-tehnjiçeskoj terminologii*", Moskva, 1961.

⁵ E. Wüster, "*Machine tool*", 1968.

⁶ Mund të përmendim një varg fjalorësh të nënfushave të ndryshme të mekanikës, kryesisht për Automobilin, për Makinat metalprerëse, Detale të makinave, etj: **a. I. Belkind**, "*English-Russian Dictionary on Machine Elements*" (10000 terma), Moskva, 1959; **b. V. Shvarc**, "*Kratkij iljustrirovanij russko-anglijskij slovar po mashinostroenjiju*" (3395 terma), Moskva, 1983; **c. Ju. Kerzhenjeviç**, "*Italiansko-russkij avtomobilnij slovar*" (rreth 10000 terma), Moskva, 1969; **d.** "*Anglo-russkij teplotehnjiçeski slovar*" (23000 terma), Moskva, 1966.

Puna e organizuar me terminologjinë në Shqipëri

Në Shqipëri puna e organizuar me terminologjinë ka nisur disa dhjetëvjeçarë më vonë (pas Luftës së Dytë Botërore) në krahasim me vendet e tjera të Evropës Perëndimore, deri diku edhe të Evropës Lindore. Kjo punë është përqendruar kryesisht në hartimin e fjalorëve terminologjikë, mbështetur mbi bazën e terminologjive të krijuara në fusha të ndryshme të dijes në gjuhën shqipe nën ndikimin e kontakteve me letërsinë shkencore-teknike të gjuhëve të huaja (kryesisht të gjuhës ruse), si edhe si rrjedhojë e futjes në Shqipëri të teknologjive moderne dhe të lidhjes me revolucionin shkencor-teknik pothuajse në të gjitha sferat e veprimtarisë njerëzore, sikurse në çdo vend të botës. Vështruar nga kjo pikëpamje mund të nënvizohet se puna në fushën e praktikës terminologjike i ka paraprirë deri në vitet 80 -të shek. XX punës studimore dhe kërkimore në këtë fushë. Deri në këtë kohë ka vijuar puna për hartimin e fjalorëve të serisë terminologjike, ku si objekt janë bërë fushat e gjera të dijes, midis tyre edhe fusha e mekanikës.⁷ Megjithatë parimet dhe metodat, mbi të cilat u hartuan fjalorët u huajtën (huazuan) nga përvoja e gjuhëve të vendeve të tjera me terminologji të zhvilluara..

Pas viteve 80-të, krahas hartimit të fjalorëve terminologjikë, jo vetëm të fushave të gjera, por edhe të ngushta, filloi një veprimtari e vullshme për përgjithësimin e përvojës së arritur nga puna për hartimin e fjalorëve të shumtë, e cila u konkretizua fillimisht në trajtimin e një vargu problemesh teorike në artikuj e punime shkencore, kurse më vonë problemet teorike, të përgjithshme e të veçanta, u pasqyruan në punime në nivel monografish. Si objekt studimi⁸ u bënë terminologjitë e fushave të dijes si fushat e ekonomisë, e mekanikës, e mjekësisë, e gjeografisë, e kohët e fundit edhe fusha e agronomisë.

Duhet theksuar se në fokusin e vështrimit studiuesit terminologë vunë probleme të terminologjive të fushave pak a shumë të gjera brenda kufijve të gjuhës shqipe. Mund të pohohet se deri më sot nuk është ndërmarrë ndonjë studim për terminologjinë shqipe për ndonjë fushë të veçantë të

⁷ 1. "Fjalor i terminologjisë tekniko-shkencore", 8. "Terminologjia e mekanikës" (shqip-rusisht-frëngjisht), Tiranë, 1963. 2. "Fjalor i termave themelore të mekanikës", Tiranë, 2002.

⁸ Janë shkruar një varg monografish, të mbrojtura si tema disertacionesh (nga 1983 deri më sot), ndërmjet tyre përmendim: **1. V. Dervishi**, "Terminologjia e mekanikës në gjuhën shqipe", Tiranë, 1989. **2. S. Pllana**, "Leksiku terminologjik bazë i mekanikës në gjuhën shqipe në përfaqje me gjuhën angleze" FGJH, Tiranë, 2010.

dijes në rrafshin përqasës me ndonjë gjuhë të huaj në mënyrë të gjerë e të plotë. Për këtë arsye do të dilte si nevojë e domosdoshme trajtimi i një fushe të ngushtë të dijes, sidomos i asaj fushe, e cila ka interes të veçantë nga pikëpamja e problematikës së saj, duke e vështruar në rrafshin përqasës edhe me një gjuhë të huaj (ose edhe me gjuhë të tjera), të cilat shërbejnë si gjedhe standardizimi në rrafsh gjuhësor. Siç është bërë e pranueshme deri më sot, vendin e parë ndërmjet këtyre gjuhëve e zë gjuha angleze, e cila në kohët e sotme ka fituar të drejtën e një gjuhe me shtrirje të gjerë ndërkombëtare. Sigurisht këtu terminologjia e kësaj gjuhe në rrafshin përqasës me një terminologji të shqipes (ose me terminologjinë e saj në përgjithësi) do të hidhte dritë mbi mjaft probleme të terminologjisë shqipe, sidomos për zgjidhjen e çështjeve të sistemit dhe standardizimit të terminologjisë. Në mënyrë të veçantë në këtë rrafsh përqasës me gjuhën angleze mund të zgjidheshin edhe probleme të qëndrimit ndaj termave të huaj, si edhe termave të shqipëruar deri më sot.

Puna e organizuar me terminologjinë në Kosovë

Në Kosovë puna në fushën e terminologjisë shqipe, në kuadrin e Federatës së Jugosllavisë, u kufizua më tepër në riprodhimin e fjalorëve terminologjikë, të hartuar në Shqipëri, duke i shoqëruar me terma nga gjuha serbe

Leksiku i terminologjisë së mekanikës- një rreze e gjerë përdorimi

Ndër terminologjitë e fushave të ndryshme të dijes, sidomos të shkencave të zbatuara, një leksik me interes të veçantë studimi përbën terminologjia e mekanikës. Kjo lidhet, nga njëra anë, me vetë mekanikën si shkencë bazë teknike me rreze të gjerë zbatimi brendapërbrenda caqeve të veta, kurse, nga ana tjetër, me integrimin e saj në mjaft fusha të tjera të dijes, duke filluar me ato më tradicionale (të elektricitetit, të ndërtimit), si edhe me ato më moderne (të elektronikës, të kompjuteristikës etj). Përveç kësaj, në themel të bazave të saj teorike dhe praktike qëndrojnë konceptet kryesore të të gjitha shkencave themelore si e matematikës, e gjeometrisë, e fizikës dhe e kimisë. Kjo lidhje e gjerë komplekse dhe e shumëfishtë e mekanikës si shkencë me mjaft fusha të dijes bën që edhe leksiku i saj terminologjik të ketë një rreze të gjerë përdorimi dhe, si e tillë, për këtë arsye, ka tërhequr dhe tërheq edhe sot vëmendjen e studiuesve të fushës së terminologjisë. Shumë dukuri që vihen re në të, në rrafshin e fjalëformimit (të termformimit) në atë të semantikës (si sinonimia, polisemia) shërbejnë si

model për zgjidhjen e problemeve të ndryshme me vlerë teorike dhe praktike për terminologjinë shqipe në përgjithësi.

Deri më sot në literaturën gjuhësore shqipe rreth problemeve të leksikut terminologjik, terminologjia e mekanikës është bërë objekt i drejtpërdrejtë studimi në punimin monografik, të mbrojtur si temë disertacioni⁹, si edhe është trajtuar edhe në artikujt shkencorë¹⁰. Përveç kësaj kjo terminologji është përpunuar si leksik i nënfushave të veçanta në standarde teknike dhe është pasqyruar edhe në rubrika të veçanta në revista teknike¹¹.

Studimet e ndërmarra në fushë të terminologjisë së mekanikës si dhe përpunimi i saj, pasqyruar në fjalorët përkatës, jep mundësinë për të bërë një analizë më të thellë në pjesë të caktuara të saj, për të shtruar e zgjidhur prej këtej një varg problemesh që lidhen si me këtë terminologji të veçantë, ashtu edhe me terminologjitë e tjera. Vështruar nga kjo pikëpamje do të ishte me interes që kjo terminologji të studiohej në pjesën që përbën bazat e ndërtimit të saj, mbi të cilat ngrihet gjithë struktura si sistem leksikor me të gjithë nënsistemet që e përbëjnë atë në përputhje me vetë degëzimin e nënsistemeve të tjera konceptore si pjesë e një të tërë (siç mund të përmenden terminologjia e teknologjisë mekanike, e termoteknikës, e automobilit, etj.)

Përfundim

Nga sa shtjelluam më sipër del se studimi i bazave të terminologjisë së mekanikës nga këndvështrimi i aspekteve themelore të teorisë dhe të praktikës terminologjike në ni këtë punim, sidomos duke i vështruar këto aspekte në rrafshin ballafaques me një gjuhë tjetër, që shërben si gjuhë standardizuese, siç është në rastin tonë gjuha angleze, mund të ishte një ndihmesë me vlerë në fushën e studimeve për terminologjinë e mekanikës në veçanti dhe për terminologjinë e një fushe speciale të saj si leksik i veçantë.

⁹ Shih 8.

¹⁰ **1. V. Dervishi**, "Termet e mekanikës në gjuhën shqipe dhe burimi i tyre konceptor", "Sf", 1991/1; **2. A. Duro**, "Fjala shqipe në terminologjinë e mekanikës", "Sf", 1984/4; **3. a. S. Pllana**, "Çështja e sinonimisë në fushën terminologjisë së mekanikës teorike" Teknika, 1/06, Universiteti i Prishtinës FSHTA Ferizaj, 2006; **3. b. S. Pllana**, "Disa çështje të formimit të termave inxhinierike në gjuhën shqipe", Teknika, 2/07, Universiteti i Prishtinës FSHTA Ferizaj, 2007.

¹¹ G. Pllana, S. Pllana, "Terminologjia për teorinë e makinave dhe mekanizmave", pjesa I-VIII, Teknika (2/03 deri 2/08), Universiteti i Prishtinës FSHTA Ferizaj, 2005 deri 2008.

Për të hedhur dritë sa më qartë mbi terminologjinë në fjalë lidhjet sistemore duhen vështruar në kuadrin e njëkuptimësisë së termave dhe të realizmit të kësaj njëkuptimësie në çdo mikrosistem, të saktësisë së termave dhe të motivshmërisë së tyre.

Bibliografi

- Duro, A.: “Termi dhe fjala në gjuhën shqipe”, Tiranë, 2009.
- Duro, A.: “Terminologjia si sistem”, Tiranë, 2002.
- Felber, H.: “Terminology manual”, UNESCO and Infoterm, Paris, 1984.
- Kostallari, A.: “Baza popullore e gjuhës shqipe dhe i ashtuquajtimi purizëm” në “SF”, 1990/2, Tiranë, 1990.
- Leka, F.: “Udhëzues për përpunimin e terminologjisë tekniko-shkencore”, Tiranë 1983.
- Lotte, D.: “Osnovi postrojenja naučno-tehnjičeskoj terminologii”, Moskva, 1961.
- Pasho, H.: “Terminologjia e ekonomisë në gjuhën shqipe nga Rilindja deri në vitet ’80 të shek. XX”, ASHSH, Tiranë, 2005.
- Pllana, G.; Pllana, S.: “Terminologjia për teorinë e makinave dhe mekanizmave”, pjesa I-VIII, Teknika (2/03 deri 2/08), Universiteti i Prishtinës FSHTA Ferizaj, 2005 deri 2008.
- Pllana, S.: “Standardizimi i terminologjisë për teorinë e makinave dhe mekanizmave në anglisht, gjermanisht dhe shqip”, Mikrotezë, Tiranë, 2006.
- Sager, J.: “A Practical course in Terminology Processing”, Amsterdam, 1990.
- Samara, M.: “Leksiku politiko-shoqëror në gjuhën shqipe”, Tiranë, 2009.
- Thomai, J.: **“Prejardhja semantike në gjuhën shqipe”, Tiranë, 1989.**
- Wüster, E.: “Internationale Sprachnormung in der Technik”, UDI, Berlin, 1931.
- Wüster, E.: “Machine tool”, 1968.
- Wüster, E.: “Einführung in die allgemeine Terminologielehre und terminologische Lexikographie”, 3. Auflage. Romanistischer Verlag, Bonn, 1991.